



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 993/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dega në Prishtinë, paraqitur kundër Nazim Rrustemit dhe Nazif Nazifit – Vëzhgues të LDK-së nga Gjilani, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për raundin e dytë të Zgjedhjeve Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, morri këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) dega në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 02.12.2013 në ora 16:00 nga parashtruesi i ankesës KDI ku ka pretenduar se, në afërsi të Qendrës së Votimit QV 0423D/03D janë vendosur posterët e LDK-së nga Naim Rrustemi. Më tutje ka shtuar se, pasi që ata janë larguar i njëjti në formë të protestës ka hyrë dhe votuar publikisht edhe përkundër paralajmërimeve që mos ta bëjë një veprim të tillë. Për më tepër ka theksuar se, përveq kësaj Nazif Nazifi – Vëzhgues i LDK-së e ka kërcënuar Skender Abazin - Vëzhgues i KDI-së në mënyrë që të mos e raportoj këtë ngjarje, pasi që e ka kanosur se do të përgjigjet me dhunë fizike ndaj tij.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik LDK, me datën 03.12.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 04.12.2013 deri në ora 10:00. PZAP-i nuk e pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik LDK sipas afatit të caktuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

ankesa është e pabazuar

Me ankesën e parashtruar nga KDI-ja pretendohet se në afërsi të Qendrës së Votimit QV 0423D/03D ka ndodhur vendosja e posterëve të LDK-së, votimi publik si dhe kanosja e Skender Abazit - Vëzhgues i KDI-së, pra veprime këto të kryera nga Nazim Rrustemi dhe Nazif Nazifi – Vëzhgues të LDK-së.

PZAP-i, konstatoi se pretendimet e tilla ankimore janë të përgjithshme dhe të pa qarta për tu vërtetuar, pasi që mungojnë prova bindëse me të cilat vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar, prandaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 993/2013 më datën 04.12.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shata



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.